



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77 / 16 gusht 2010), nenin 5 paragrafi 5.3, nënparagrafi f, dhe paragrafi 5.4, si dhe nenin 15, paragrafi 15.7, nënparagrafi e, nenin 20, paragrafi 1, nënparagrafi d, nenin 22, paragrafi 22.7, nënparagrafi e, të Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), si dhe nenin 11 të Ligjit Nr. 05/L -116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115 dhe Ligjin Nr. 04/L-168 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 3/17 janar 2017). Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2022 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR AUDITIMIN E JASHTËM TË FONDEVE PENSIONALE DHE OFRUESVE TË PENSIONIT

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë kushtet dhe kërkesat për aprovimin e auditorëve të jashtëm për kryerjen e auditimit të jashtëm të fondeve pensionale, si dhe raportet ndërmjet auditorit të jashtëm, Fondit dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK).
2. Kjo Rregullore zbatohet për Fondin e Kursimeve Personale të Kosovës (këtu e tutje FKPK), fondet e tjera pensionale dhe ofruesit e pensionit të licencuar nga BQK për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim siç janë të përcaktuara në nenin 1 të Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe nenin 1 të Ligjit Nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, ose me përkufizimet për qëllimin e kësaj Rregullore si në vijim:
 - 1.1. **Firmë auditimi** – nënkupton një person juridik ose çfarëdo entiteti tjetër, pa marrë parasysh formën ligjore, që është i licencuar në përputhshmëri me Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (këtu e tutje: Ligji për raportim financiar) për të kryer auditimin ligjor;
 - 1.2. **Auditor i jashtëm** – nënkupton vetëm firmën e auditimit;
 - 1.3. **Auditimi i jashtëm** – nënkupton auditimin e llogarive vjetore apo llogarive të konsoliduara, në pajtim me legjislacionin e fondeve pensionale në Kosovë;

- 1.4. **Fond pensional** – nënkupton FKPK-në, fondet tjera pensionale të licencuara nga BQK, duke përfshirë ofruesit e pensioneve;
- 1.5. **Ofruesi i pensioneve** – nënkupton institucionet financiare, bankat, instrumentet për investime të hapura dhe kompanitë e sigurimeve që sigurojnë pensionet plotësuese individuale në pajtim me ligjin për fondet pensionale;
- 1.6. **Pasqyrat financiare** – nënkupton bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet plotësuese dhe materialet sqaruese, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare;
- 1.7. **SNA** – nënkupton Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Neni 3

Kushtet dhe dokumentacioni i kërkuar

1. Auditori i jashtëm i një fondi pensional aprovohet nga BQK.
2. Bazuar në aplikacionin me shkrim, BQK aprovon auditor të jashtëm të një fondi pensional vetëm nëse plotësohen kushtet si në vijim:
 - 2.1. Një auditor të jashtëm të licencuar në Kosovë në pajtim me Ligjin për raportim financiar, i cili njëkohësisht mban anëtarësinë e rregullt në një shoqatë profesionale të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë.
 - 2.2. Një auditor të jashtëm që ka së paku 3 (tre) vjet eksperiencë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të institucioneve financiare apo stafi pjesëmarrës i të cilit kryen auditimin të ketë një eksperiencë të tillë.
3. Auditorët e jashtëm për të mbajtur pozitat e tyre respektive si auditorë të jashtëm të një fondi
 - 3.1. Pensional, duhet:
 - 3.2. Të jenë të përshtatshëm dhe të duhur;
 - 3.3. Të kenë integritet, ndershmëri dhe përkushtim për përmbushjen e detyrave të tyre;
 - 3.4. Të kenë kompetencë, aftësi profesionale dhe gjykim të shëndoshë në përmbushjen e detyrave të tyre;
 - 3.5. Duhet të kenë kualifikimet profesionale të përcaktuara, të dëshmuara me një diplomë ose certifikatë të lëshuar nga një universitet ose një organizatë e njohur profesionale që vërteton përfundimin e suksesshëm të ciklit të plotë të kualifikimeve për auditor të jashtëm;
 - 3.6. Të jenë anëtarë të një shoqate apo organizate profesionale të kontabilitetit dhe auditimit dhe që plotëson kërkesat për licencë në përputhshmëri me Ligjin për raportim financiar;
 - 3.7. Të posedojnë dhe zotërojnë njohuri profesionale sipas legjislacionit përkatës në fuqi, njohuri të etikës dhe të praktikave më të mira për fondet pensionale.
4. Përveç dispozitave të cekura më lart, BQK vlerëson sjelljen paraprake dhe aktivitetet e personit në fjalë, në biznes ose çështje financiare dhe në veçanti shqyrton nëse ka prova për të vërtetuar se ky person ka qenë apo është:

- 4.1. I dënuar brenda 10 viteve të fundit për ndonjë vepër penale;
- 4.2. I përfshirë ose i lidhur me ndonjë humbje financiare të shkaktuar nga veprimet e pandershme, të pamatura ose të pakujdesshme në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe menaxhimin e kompanive të tjera;
- 4.3. I angazhuar në praktika jo të mira tregtare të biznesit duke përfshirë evazionin fiskal, të cilat BQK i konsideron praktika mashtruese, të papërshtatshme ose kërcënuese, të cilat në një mënyrë pasqyrojnë mangësi të vlerave të një personi për të kryer shërbime financiare dhe operacione të tjera të biznesit;
- 4.4. Apo nuk ka përmbushur, ka vonuar ose nuk ka paguar tatimet po detyrime të tjera qeveritare.
5. Aprovimi që i jepet auditorit të jashtëm është i kufizuar për një fond pensional specifik dhe është i vlefshëm për një vit financiar.
6. Aplikacionet për aprovim duhet të dorëzohen në BQK para datës 30 qershor të secilit vit.
7. Për të marrë aprovimin e BQK-së për auditorin e jashtëm, fondet pensionale duhet të paraqesin dokumentacionin si në vijim:
 - 7.1. Propozimin e komitetit të auditimit dhe përcaktimin e bordit drejtues për emërimin e auditorit jashtëm;
 - 7.2. Programin e auditimit të fondit pensional;
 - 7.3. Letrën e angazhimit të auditorit të jashtëm ose kontratën e shërbimit të ofruar; Dokumentin që vërteton përvojën e mjaftueshme të auditorit të jashtëm, së paku tri (3) vite apo të stafit të tij i cili kryen auditimin në fushën e auditimit të fondeve pensionale apo institucioneve të tjera financiare;
 - 7.4. Vërtetimin e lëshuar nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) në lidhje me rezultatet e kontrollit të fundit të cilësisë për auditorin e jashtëm (ky vërtetim nuk do të kërkohet nga BQK, derisa KKRF të mund të lëshojë një vërtetim të tillë);
 - 7.5. Deklaratën me shkrim të auditorit të jashtëm mbi përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në nenin 6 të kësaj Rregulloreje;
 - 7.6. Programi i auditimit dhe shfrytëzimi i burimeve gjatë shërbimit të auditimit, duhet të jetë i përshtatshëm në raport me karakterin dhe madhësinë e fondeve pensionale;
 - 7.7. Të dhëna të tjera specifike të kërkuara nga BQK.
8. Angazhimi i vazhdueshëm i auditorit të jashtëm të njëjtë është i kufizuar në pesë vite apo pesë auditime të njëpasnjëshme dhe i njëjti mund të marrë pjesë në auditimin e jashtëm të fondit pensional pas mbarimit të afatit kohor prej të paktën tri vjetësh nga auditimi i fundit.

Neni 4

Aprovimi ose refuzimi i auditorëve të jashtëm

1. BQK brenda 20 ditësh pune nga data e parashtrimit të dokumentacionit të plotë të kërkuar sipas nenit 3 të kësaj Rregulloreje aprovon ose refuzon auditorin e jashtëm.

2. Në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, BQK njofton auditorin e jashtëm brenda 15 ditësh, nga data e pranimit të aplikacionit me dokumentacion jo të plotë. Mangësitë duhet të plotësohen nga fondi pensional brenda 20 ditë pune nga njoftimi i BQK-së.
3. BQK aprovon auditor të jashtëm të një fondi pensional, auditorët e jashtëm që kanë reputacion të mirë dhe të cilët nuk janë të angazhuar në ndonjë aktivitet, i cili nuk është në përputhshmëri me funksionet e auditimit të jashtëm.
4. BQK mund të refuzojë auditorin e jashtëm kur vlerëson se ky auditor i jashtëm, në auditimin paraprak, nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje ose me kërkesat për të cilat ka rënë dakord me shkrim.

Neni 5

Ribërja e auditimit

BQK ka të drejtë të kërkojë ribërjen e auditimit nga një tjetër auditor i jashtëm me shpenzimet e fondeve pensionale, në rastet kur auditori i jashtëm ekzistues i fondeve pensionale e ka kryer auditimin ose ka paraqitur një raport, i cili nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit për fondet pensionale, rregulloret e BQK-së, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) dhe nuk e shpreh gjendjen financiare të vërtetë dhe të saktë të fondeve pensionale.

Neni 6

Etika profesionale

Auditorët e jashtëm duhet t'i nënshtrohen parimeve të etikës profesionale të përcaktuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve "Kodi i etikës për Kontabilistët Profesional".

Neni 7

Pavarësia dhe objektiviteti

1. Gjatë kryerjes së auditimit, auditorët e jashtëm duhet të jenë të pavarur nga entiteti që auditohet dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshihen në vendimet e menaxhmentit të fondeve pensionale që auditohen. Auditorët e jashtëm nuk duhet të kryejnë auditimin, nëse ekziston ndonjë marrëdhënie direkte apo indirekte financiare, pune, punësimi apo çfarëdo marrëdhënie tjetër, përfshirë edhe provizionin për shërbimet joaudituese shtesë, ndërmjet auditorëve të jashtëm dhe fondeve pensionale që auditohen, nga e cila një palë e tretë objektive e arsyeshme dhe e informuar mund të konkludonte se pavarësia e auditorëve të jashtëm është kompromentuar.
2. Auditorët e jashtëm duhet të dokumentojnë në letrat e punës së auditimit, të gjitha cenimet e pavarësisë së tyre, si dhe masat e sigurisë që i kanë ndërmarrë për zbutjen e atyre cenimeve.

Neni 8

Pavarësia dhe objektiviteti i auditorëve jashtëm të cilët kryejnë një auditim në emër të firmave audituese

Pronarët apo aksionarët e një firme audituese të aprovuar, gjithashtu edhe anëtarët e organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse të asaj firme apo të një firme të asociuar, nuk duhet të ndërhyjnë në ekzekutimin e ndonjë auditimi në çfarëdo mënyre, që rrezikon pavarësinë dhe objektivitetin e auditorit, i cili kryen auditimin në emër të firmës audituese.

Neni 9

Tarifat e auditimit

1. Tarifat e shërbimeve të auditimit:
 - 1.1. Duhet të jenë adekuate që të mundësojnë kualitetin e duhur të auditimit;
 - 1.2. Nuk duhet të jenë të influencuara apo të përcaktuara nga provizioni i shërbimeve plotësuese të fondeve pensionale që auditohen, dhe
 - 1.3. Nuk mund të bazohen në asnjë formë të kushtëzimit.

Neni 10

Kërkesat ndaj auditorëve të jashtëm

1. Auditorët e jashtëm duhet të kryejnë të gjitha auditimet e fondeve pensionale në pajtim me SNA.
2. Auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë nëse llogaritë vjetore të fondit pensional janë përgatitur dhe finalizuar në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar (SNRF), me Ligjin për fondet pensionale dhe rregulloret përkatëse të BQK-së.
3. Auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë nëse menaxhmenti i fondit pensional e ka plotësuar apo jo obligimin e tij për të siguruar shënime të qarta dhe të duhura, si dhe dokumentimin e informatave kontabël në pajtim me Ligjin për fondet pensionale dhe rregulloret e BQK-së.
4. Auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë mjaftueshmërinë e sistemeve të administrimit të rreziqeve të fondeve pensionale, duke u bazuar në vlerësimin e:
 - 4.1. Përputhshmërisë me kërkesat për strukturat organizative në lidhje me administrimin e çdo rreziku specifik;
 - 4.2. Politikave dhe procedurave për administrimin e çdo rreziku specifik si dhe të zbatimit të tyre;
 - 4.3. Mjaftueshmërisë së identifikimit, matjes dhe monitorimit të çdo rreziku specifik;
 - 4.4. Mjaftueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit të auditimit të brendshëm në lidhje me administrimin e çdo rreziku specifik.
5. Auditorët e jashtëm bëjnë vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe të cilësisë së akteve nënligjore dhe të procedurave me të cilat operojnë fondet dhe zbatimin e tyre. Kjo përfshin vlerësimin nga ana e auditorit të jashtëm si në vijim:

- 5.1. Organizimin dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të fondit pensional;
 - 5.2. Cilësinë dhe zbatimin e rregulloreve të brendshme të fondit pensional për administrimin e aktiveve dhe pasiveve;
 - 5.3. Organizimin e sistemit të teknologjisë së informacionit dhe koordinimin e tij me objektivat e fondit pensional dhe me ruajtjen e integritetit të të dhënave.
6. Auditorët e jashtëm kërkojnë paraprakisht dhe vlerësojnë shqetësimet e BQK-së për aspekte të veçanta të veprimtarisë së fondeve pensionale.
 7. Auditorët e jashtëm përgatitin një raport në të cilin shprehin opinionin dhe vlerësimin e tyre mbi rezultatet e nxjerra për organizimin dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të fondeve mbi cilësinë e rregulloreve dhe akteve të brendshme të fondeve dhe zbatimin e tyre, të cilin e dorëzojnë te drejtuesit e fondeve.
 8. Për qëllim të nënparagrafit 4.4 të këtij neni, rreziqet specifike përfshijnë: rrezikun e investimeve, rrezikun e tregut, rrezikun operacional, rrezikun e likuiditetit dhe rreziqet e tjera ndaj të cilave fondet pensionale ekspozohen.
 9. Letrat e punës së auditimit duhet të përgatiten dhe mirëmbahen në pajtim me SNA përkatëse.
 10. Auditorët e jashtëm kryejnë një vlerësim për fondin lidhur me mënyrën e menaxhimit të mjeteve pensionale dhe vendosjen e kontrolleve të brendshme të duhura.
 11. Auditimi i fondeve pensionale duhet të mbulojë fusha të tilla si të portfoliove të mjeteve pensionale, performancës së investimeve, mjeteve joperformuese, vlerësimin të mjeteve, tregtimit dhe aktiviteteve të tjera të letrave me vlerë, derivateve të instrumenteve financiare, siguri të mjeteve dhe mjaftueshmërinë e kontrolleve të brendshme mbi raportimin financiar.

Neni 11

Detyrat e auditorëve të jashtëm

1. Auditorët e jashtëm duhet të kryejnë auditimet sipas gjykimit të tyre profesional përfshirë vlerësimin e rrezikut, që paraqet përfshirja e informatave të gabuara në llogaritë vjetore për shkak të parregullsive dhe gabimeve.
2. Auditorët e jashtëm duhet të sigurojnë se kanë bazë të mjaftueshme për të vlerësuar nëse është bërë ndonjë shkelje e Ligjit për fondet pensionale dhe rregulloreve përkatëse të BQK-së, të cilat janë materiale sa i përket llogarive vjetore.
3. Auditorët e jashtëm duhet të kontrollojnë rregullsinë, saktësinë dhe plotësinë e raportimeve të fondeve pensionale të paraqitura në BQK, në përputhje me kërkesat rregullative në fuqi të miratuara nga BQK dhe nëse ato pasqyrojnë në mënyrë realiste dhe objektive gjendjen financiare të fondit pensional.
4. Auditorët e jashtëm ia paraqesin me shkrim bordit drejtues të fondeve rrethanat si në vijim:
 - 4.1. Mangësitë në lidhje me detyrimin për të siguruar regjistrimin e duhur, shpalosjen e qartë dhe dokumentimin e informatave kontabël;
 - 4.2. Gabimet dhe mangësitë në organizimin dhe kontrollin e menaxhimit të mjeteve;

- 4.3. Parregullsitë dhe gabimet që mund të shkaktojnë informim të gabuar në llogaritë vjetore; dhe
- 4.4. Rrethanat që mund të shkaktojnë detyrime të anëtarëve të bordit drejtues, asamblesë së përgjithshme të aksionarëve apo menaxhmentit të lartë.

Neni 12

Dokumentimi i kryerjes së detyrës

Ashtu siç kërkohet me SNA 230, “Dokumentimi i Auditimit”, auditorët e jashtëm duhet të dokumentojnë si është kryer një auditim, si dhe rezultatet e një auditimi. Çështjet të cilat tregojnë se parregullsitë ose gabimet mund të jenë të pranishme, duhet të dokumentohen në mënyrë të veçantë.

Neni 13

Raporti i auditorëve të jashtëm

1. Auditorët e jashtëm duhet të përgatitin një raport vjetor të auditimit me një opinion të auditimit në pajtim me SNA.
2. Raporti i auditimit duhet të konfirmojë që shërbimet e auditimit janë kryer në pajtim me dispozitat e Ligjit për fondet pensionale, kësaj Rregullore dhe rregulloreve të tjera relevante të BQK-së.
3. Raporti i auditimit duhet të verifikojë dhe shpalosë të paktën çështjet si në vijim:
 - 3.1. Bilancin financiar, përfshirë shënimet në të;
 - 3.2. Llogarinë fitim-humbje, përfshirë shënimet në të;
 - 3.3. Raportin për asetet neto të fondit;
 - 3.4. Raportin për ndryshimet në asetet neto të fondit
 - 3.5. Raportin për kuotat e pensionit dhe strukturën e investimeve;
 - 3.6. Veprimtarinë e kontrollit të brendshëm;
 - 3.7. Mbajtjen e regjistrave kontabël;
 - 3.8. Vlerësimin e zërave të bilancit dhe atyre jashtë bilancit;
 - 3.9. Shpërndarjen e fitimit;
 - 3.10. Pasqyrën e qarkullimit të mjeteve monetare.
4. BQK, ka të drejtë t’ia kthejë raportin auditorit të jashtëm, nëse nuk është përgatitur në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje, si dhe ka të drejtë të caktojë një auditor tjetër të jashtëm, me shpenzimet e fondit pensional për ta hartuar raportin, në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.
5. Nëse llogaritë nuk japin informata lidhur me rezultatin dhe gjendjen e fondeve pensionale, e që duhet të sigurohen, auditorët e jashtëm duhet të theksojnë këtë ose të përcaktojnë opinionin e

rezervuar të auditorëve dhe mundësisht të sigurojnë edhe informata të nevojshme plotësuese në raportin e auditimit.

6. Nëse auditorët e jashtëm arrijnë në përfundim se llogaritë nuk duhet të përfundohen në formën e tyre aktuale, kjo duhet të theksohet në mënyrë të qartë.
7. Nëse auditorët e jashtëm, gjatë kryerjes së auditimit, zbulojnë çështje që mund të shkaktojnë detyrime të anëtarëve të bordit të drejtues, asamblesë së përgjithshme të aksionarëve apo menaxhmentit të lartë, kjo paraqitet në raportin e auditimit. Auditorët e jashtëm, gjithashtu duhet të ofrojnë informata të tjera në lidhje me rrethanat, për të cilat besojnë se duhet njoftuar bordi drejtues apo aksionarët e fondit pensional.
8. Auditorët e jashtëm duhet të vlerësojnë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditorët e jashtëm për vitin paraprak financiar.

Neni 14

Letra e menaxhmentit

1. Auditorët e jashtëm, duhet të përgatitin letrën finale të menaxhmentit për fondin pensional, për konkludimet e procesit të auditimit. Letra e menaxhmentit duhet të përfshijë të gjitha konkluzionet në të cilat mund të ketë arritur auditori i jashtëm në lidhje me aktivitetin apo gjendjen financiare të fondit pensional, si dhe informatat në lidhje me kujdesin e tyre në mision të auditimit.
2. Në letrën finale të menaxhmentit, auditorët e jashtëm duhet të japin një deklaratë specifike në lidhje me sistemin e kontroleve të brendshme, me qëllim që të japin siguri specifike për qëllim të shpalosjes së çështjeve materiale në strukturën e kontrollit të brendshëm. Deklarata specifike, gjithashtu duhet të përfshijë funksionin e auditimit të brendshëm.
3. Në letrën e menaxhmentit, auditorët e jashtëm duhet të bëjnë një deklaratë specifike nëse ata arrijnë në përfundimin se fondi pensional është në pajtim me ligjin për fondet pensional, rregulloret përkatëse të BQK-së dhe nëse fondi pensional ka vepruar sipas rekomandimeve të fundit të BQK-së për të përmirësuar gjetjet.

Neni 15

Fshehtësia

1. Auditorët e jashtëm dhe bashkëpunëtorët e auditorëve të jashtëm, kanë për detyrë të ruajnë fshehtësitë sa i përket çfarëdo njohurie të përfituar gjatë kohës së aktiviteteve të tyre, përveç nëse me ligj përcaktohet ndryshe apo në rastet kur informata ka të bëjë me personin, detyra e të cilit nuk kërkon fshehtësinë profesionale. Auditorët e jashtëm dhe bashkëpunëtorët e auditorëve të jashtëm nuk mund t'i shfrytëzojnë ato informata për aktivitetet e veta, për shërbim apo punësim të të tjerëve.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, informacioni mund t'i zbulohet vetëm BQK-së apo në rastet tjera kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi.
3. Detyrimi i mbajtjes së fshehtësisë vazhdon të zbatohet edhe pasi të ketë përfunduar detyra e tillë.

Neni 16

Obligimi për të informuar

1. Auditori i jashtëm brenda kornizave të detyrës së tij duhet të ofrojë informata në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me fondet pensionale, të cilat auditori i jashtëm i ka mësuar gjatë kohës së auditimit, kur kjo kërkohet nga mbledhja e përgjithshme e aksionarëve, bordi i drejtorëve, menaxhmenti i lartë, komiteti i auditimit apo nga një person i autorizuar nga BQK.
2. Auditori i jashtëm, duhet menjëherë t'i komunikojë komitetit të auditimit apo bordit të drejtues të fondit pensional, ndonjë çështje me interes për qeverisje, të cilën e ka vërejtur gjatë kryerjes së auditimit. Auditori i jashtëm, duhet menjëherë të njoftojë organet drejtuese të fondit pensional dhe BQK-në, në rastet kur gjatë kryerjes së auditimit të fondit pensional, ai vëren:
 - 2.1. Informatën që shfaq shenja të dështimit në përmbushjen e kërkesave nga licenca e dhënë nga BQK;
 - 2.2. Një konflikt serioz brenda organeve vendimmarrëse apo largimin e papritur të menaxherit që ka pasur funksion kyç;
 - 2.3. Informatën e cila tregon se mund të ketë shkelje materiale të ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve dhe urdhrave të BQK-së, si dhe statutit dhe të akteve nënligjore të fondeve pensionale; ose
 - 2.4. Synimin e auditorit të brendshëm për të dhënë dorëheqje apo largimin e tij dhe ndryshimet negative apo materiale që paraqesin rrezik për punën e fondit pensional dhe mundësinë që rreziku të vazhdojë.
3. Auditorët e jashtëm, në bazë të kërkesës së BQK-së, duhet t'i ofrojë BQK-së çfarëdo informate gjatë tërë misionit të auditimit, në lidhje me performancën e tij në shërbimet e auditimit të një fondi.
4. BQK mban kontakte të rregullta dhe mund të iniciojë takime me auditorin e jashtëm të fondeve pensionale në çdo kohë kur kontaktet e tilla konsiderohen të nevojshme.

Neni 17

Kontrolli i cilësisë dhe rishikimi tij

1. Auditorët e jashtëm të aprovuar nga BQK duhet të aplikojnë politikat dhe procedurat adekuate të kontrollit të cilësisë të cilat i adresojnë të gjitha aspektet e rëndësishme të auditimit.
2. Auditorët e jashtëm të aprovuar nga BQK, janë subjekt i një rishikimi të cilësisë së dhënies së sigurisë, nga ana e BQK-së.
3. Rishikimi i cilësisë të një auditori të jashtëm të aprovuar, duhet të përfshijë një detyrë specifike të auditimit dhe duhet të kryhet nga ana e BQK-së apo nga ana e një rishikuesi të caktuar nga BQK.
4. Gjatë rishikimit të cilësisë, BQK apo rishikuesi duhet të përcaktojë se deri në çfarë mase, auditori i jashtëm i ka aplikuar rregullat dhe procedurat adekuate të kontrollit të cilësisë, në të gjitha aspektet e rëndësishme të auditimit. Gjatë rishikimit, BQK apo rishikuesi duhet të ketë

qasje në të gjitha dokumentet e punës së auditorit të jashtëm deri në atë masë, që është e nevojshme për të kryer një kontroll adekuat të cilësisë.

5. Duke pasur parasysh obligimet për ruajtjen e fshehtësisë, neni 15 i kësaj Rregullore zbatohet për BQK-në dhe për rishikuesin e caktuar nga BQK.
6. Rezultatet e përmbledhura të rishikimit të cilësisë së dhënies së sigurisë të një auditori të jashtëm të aprovuar, publikohen nga BQK, duke përfshirë rekomandimet, zbatimin e rekomandimeve dhe nëse ndodh ndonjë rast edhe sanksionet.

Neni 18

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale

Auditorët e jashtëm duhet të sigurojnë policë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, siç përcaktohet me Udhëzimin administrativ 01/2019 për licencimin e auditorëve ligjorë dhe firmave vendore e të huaja ligjore të auditimit, të Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar (KKRF).

Neni 19

Shkarkimi dhe dorëheqja

1. Auditorët e jashtëm të fondeve pensionale mund të shkarkohen nga fondi pensional vetëm kur ekziston bazë e mjaftueshme për këtë. Dallimet e opinioneve të trajtimeve në kontabilitet ose në procedura të auditimit, nuk mund të konsiderohet si bazë e mjaftueshme për shkarkim.
2. Si fondet pensionale të audituara ashtu edhe auditorët e jashtëm, duhet të informojnë BQK-në në rast të shkarkimit apo të dorëheqjes dhe duhet të japin shpjegime të mjaftueshme për arsyet e një vendimi të tillë.

Neni 20

Tërheqja e aprovimit

1. BQK tërheq aprovimin e auditorit të jashtëm në rastet kur:
 - 1.1. BQK konstaton se aprovimi është fituar në bazë të të dhënave të rreme të qëllimshme; dhe
 - 1.2. Aprovimi i auditorit të jashtëm tërhiqet nëse reputacioni i mirë i asaj firme audituese është kompromentuar seriozisht apo nëse njëra nga kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe Ligjit për fonde pensionale nuk përmbushet më.

Neni 21

Zbatimi, masat ndaj auditorit të jashtëm

1. Nëse auditorët e jashtëm të fondeve pensionale shkelin detyrat e auditorit të përcaktuara me Ligjin për fonde pensionale, këtë Rregullore dhe rregulloret tjera përkatëse të BQK-së, BQK mund t'i shqiptojë auditorit të jashtëm një vërejtje me shkrim, një kopje e së cilës i dërgohet fondit pensional të audituar.

2. Nëse shkeljet në paragrafin 1 të këtij neni përsëriten, BQK ka të drejtë të refuzojë aprovimin e auditorit të jashtëm për t'u angazhuar në kryerjen e auditimit të fondeve pensionale të mbikëqyrura dhe licencuara nga BQK, për një periudhë deri në tre (3) vjet.
3. Nëse auditori i jashtëm apo fondi pensional nuk i plotëson kërkesat e kësaj Rregulloreje apo nëse BQK me arsye nuk është e kënaqur me performancën e auditorit, BQK ka kompetencë:
 - 3.1. të kërkojë shkarkimin ose zëvendësimin e një auditori;
 - 3.2. drejtpërsëdrejti të emërojë, shkarkojë ose zëvendësojë një auditor;
 - 3.3. të kërkojë bërjen e një riauditimi të fondit pensional me shpenzime të fondit pensional.
4. Masat e përcaktuara në këtë nen, nuk i përjashtojnë masat dhe veprimet e tjera të parapara sipas Ligjit për fonde pensionale dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 22

Shfuqizimi

Pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregulla 24 që parashkruan kërkesat në letrën e angazhimit të revizorit të jashtëm të Fondit të Pensionit dhe Siguruesve të Pensionit, e datës 23 mars 2002, si dhe Plotësim i Rregullës mbi auditimin e jashtëm dhe auditorët e jashtëm të institucioneve financiare të licencuara nga Autoritetit Qendror Bankar i Kosovës Autorizuar sipas nenit 62 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/47, i datës 1 mars 2008.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës